VENDIM
Nr. 11, datë 6.2.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "KESH" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; neneve 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "KESH" sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "KESH" sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "KESH" sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti